



Mjaft më me arsyttime për dhunën në familje

Domosdo dhuna ndodh kur dikush pi alkool ose përdor drogë.

Nuk ka arsytim për dhunën

Dhuna në familje mbetet ndër format më të përhapura të dhunës që ushtrohet në mbarë botën. Hulumtimi më i ri i Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK), *Mjaft më me arsyttime: Analizë e qëndrimeve, incidencës dhe reagimeve institucionale ndaj dhunës në familje në Kosovë*, vlerëson ndryshimet në ndërgjegjësimin e qytetarëve për dhunën në familje, incidencën dhe reagimin institucional nga viti 2008. Raporti ka për qëllim të informojë procesin e hartimit të Strategjisë së re Kombëtare dhe Planit të Veprimit mbi dhunën në familje, që do të startojë në vitin 2016, si dhe tu ofrojë institucioneve individuale rekomandime konkrete për përmirësimin e qasjes së tyre në adresimin e dhunës në familje.

Hulumtimi ka zgjatur 10 muaj dhe ka përdorur metoda mikse duke përfshirë anketimin nëpër familje të Kosovës me 1315 intervista të bëra me gratë dhe burrat e të gjitha grupeve etnike, të përzgjedhur rastësisht mbi moshën 18 vjeçare si dhe intervista me më shumë se 200 përfaqësues të institucioneve dhe akterëve të tjerë kyç dhe rishikimin e kornizës ligjore.

Çka është dhuna në familje?

Ligi për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje (2010) përcakton aktet e dhunës në familje, si: “vepra apo lëshime të qëllimshme që i bëjnë një person personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare”. Akte të tilla mund të përfshijnë forcën fizike, presionin psikologjik, duke kërcënuar personin ose anëtarët e familjes së tij/saj, duke shkaktuar frikë, cënimin e dinjitetit, sulmin fizik, ofendimet, frikësimin, akte seksuale pa pëlqim, kufizimin e lirisë së lëvizjes, dëmtimin e pronës, hyrja apo largimi me dhunë nga banesa e përbashkët apo banesën e personit tjetër, dhe rrëmbimin. Shumë prej këtyre akteve gjithashtu përkufizohen si krime në kuadër të Kodit Penal të Kosovës. Nuk ka rëndësi nëse këto akte ndodhin brenda familjes, ‘**prapa dyerve të mbyllura**’,

ato janë prapëprap të paligjshme dhe duhet të ndiqen penalisht në përputhje me ligjin!

Ligi për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje gjithashtu përcakton se çfarë përbën një lidhje familjare. Marrëdhëniet e tilla ekzistojnë në mesin e personave në qoftë se ata tani janë ose kanë qenë ndonjëherë në të kaluarën: të fejuar, të martuar, në një marrëdhënie jashtëmartesore, bashkëjetojnë në një familje të përbashkët, në një marrëdhënie kujdestarie, janë prindër të një fëmije të përbashkët, janë palë procedurale në një mosmarrëveshje në lidhje me marrëdhëniet familjare, dhe/ose janë në lidhje gjaku, martesë ose adoptimi.

Ky ligj siguron urdhra mbrojtjeje, të cilat mund të përfshijnë disa masa të veçanta për të mbrojtur personat të cilët kanë përjetuar dhunë në familje, të tilla si: trajtimin psikosocial; ndalimit të dhunuesit nga afrimi i viktimës në një distancë të caktuar; ndalimit të shqetësimit të viktimës; largimin e kryesit nga vendbanimi i përbashkët; trajtimin mjekësor për kryesit e varur nga droga dhe alkooli; konfiskimin e armëve; urdhërimi i dhunuesit për të paguar qiranë ose alimentacionin e fëmijëve; të urdhërojë dhunuesin për të lejuar që viktimat të kthehet në shtëpi; dhe të ndalohej që dhunuesi të shes asetet.

A e keni ditur




Disa konventa ndërkombëtare janë të aplikueshme në Kosovë, të cilat na tregojnë se si shtetet duhet ti përgjigjen dhunës në familje:

- ▶ Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
- ▶ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- ▶ Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike

A ka dhunë në familje në Kosovë?

- ▶ 62% e kosovarëve kanë përjetuar një ose më shumë forma të dhunës në familje në jetën e tyre (56% burra dhe 68% gra).
- ▶ Në vitin 2014, 31% e kosovarëve kanë përjetuar dhunë (41% gra dhe 20% burra).
- ▶ Mes vitit 2005 dhe 2015, të paktën 22 persona u vranë nga persona me të cilët kishin lidhje familjare.
- ▶ Gjatë vitit 2014, 7% e kosovarëve kanë thënë se partnerët e tyre u kanë bërë presion që të kenë marrëdhënie seksuale pa pëlqimin e tyre.
- ▶ Sipas statistikave, gratë kanë më shumë të ngjarë se sa burrat të përjetojnë dhunë në familje.
- ▶ Është interesant se si nuk ka ndonjë statistikë në vitin 2014 që shpreh lidhjen mes vuajtjes së dhunës me vendndodhje gjeografike (rurale/urbane ose rajonale), nivelin arsimor, gjendjen ekonomike apo atyre që marrin ndihma sociale.



Çfarë mendojnë dhe çfarë dinë njerëzit për dhunën në familje?

- ▶ Në shumë raste njoftimi dhe informimi i njerëzve për dhunën në familje është përmirësuar që nga hulumtimi i fundit që RrGGK ka bërë në Kosovë në vitin 2008. Sot, 75.3% e kosovarëve e dinë që në Kosovë ekziston Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, përderisa vetëm 55.7% kishin njohuri për rregulloret që ekzistojnë në vitin 2008.
- ▶ Më shumë njerëz kanë tendencë të marrin në konsideratë format e ndryshme të dhunës fizike si dhunë në familje sesa në vitin 2008.
- ▶ Përkundër këtyre përmirësimeve, gati një e treta e kosovarëve besojnë se në familje “dhuna është pjesë normale e çdo marrëdhënieje, dhe shoqëria në përgjithësi pranon se dhuna mund të ndodhë ndonjëherë”.
- ▶ Një në tre kosovarë beson se dhuna në familje është “problem familjar, kështu që fqinjët nuk duhet ta raportojnë atë në polici”, gjë e cila mund të parandalojë dhunën.
- ▶ 73.6% e të anketuarve deklaruan se do ta kontaktonin policinë nëse ata përjetojnë dhunë në familje, ndërsa shumë pak prej tyre dinin për akterët tjerë që mund tu ofrojnë shërbime, si: Mbrojtësi i Viktimës, Qendrat për Punë Sociale apo Organizatat e Grave.

Si i përgjigjen institucionet dhunës në familje?

Në përgjithësi, që nga viti 2008 duket se është përmirësuar reagimi i institucioneve ndaj dhunës në familje në Kosovë. Policia në veçanti janë më të trajnuar dhe kanë përgjegjësi për detyrat e tyre. Përmirësim i rëndësishëm janë edhe gjykatat themelore, që tani kanë gjyqtarët e gjykatave civile të specializuara për rastet e dhunës në familje. Megjithatë, mbesin disa sfida:

- ▶ Shërbimet joadekuate për personat që kanë vuajtur nga dhuna, duke përfshirë strehimoret e qëndrueshme financiarisht, shërbimet për rehabilitim, këshillimet cilësore psikologjike dhe vendbanimet për të shkuar pas strehimores. Ende mbetet koordinim i dobët ndërmjet institucioneve për mbështetjen e personave që kanë përjetuar dhunë në familje.
- ▶ Shërbimet e këshillimit dhe programet e trajtimit të pamjaftueshme për autorët e dhunës.
- ▶ Mos zbatimi i masave të urdhrimit mbrojtës; si për shembull kryesi nuk paguan alimentacionin e fëmijëve.
- ▶ Disa persona, megjithëse jo të gjithë, nuk janë të trajnuar në mënyrë adekuate në kuadër të institucioneve, veçanërisht lidhur me përgjegjësitë ligjore, rëndësinë e konfidencialitetit dhe qasjen e duhur për të punuar me personat që vuajnë nga trauma e dhunës në familje.
- ▶ Disa përfaqësues të institucioneve padijeni “fajësojnë viktimën” për krimet e kryera ndaj tyre.
- ▶ Disa gjithashtu mundohen të “pajtojnë” familjet, gjë e cila nuk është pjesë e përgjegjësisë të shumicës së institucioneve sepse mund të minojnë përgjegjësitë e tyre për të siguruar mbrojtje apo drejtësi.
- ▶ Burimet e pamjaftueshme në disa institucione, duke përfshirë burimet njerëzore, hapësirën dhe furnizimet.
- ▶ Konsolidimi dhe raportimi i dobët mbi statistikën që kanë të bëjnë me rastet e dhunës në familje, duke përfshirë në procedurën penale, veçanërisht nga gjykatat dhe institucionet shëndetësore, të cilat ende nuk kanë dosje të mjaftueshme të dixhitalizuara për të lejuar monitorimin e tendencave dhe trendeve.

A mund ta besoni se

- ▶ 21% e kosovarëve pajtohen se “ndonjëherë është në rregull që burri ta godas gruan”.
- ▶ 53% mendojnë se “në qoftë se burri është i papunë, dhuna edhe mund të ndodhë ndonjëherë”.
- ▶ 24.6% besojnë se “marrëdhënia seksuale nuk mund të konsiderohet dhunë nëse ajo ndodh midis dy të rriturve të cilët janë të martuar”.
- ▶ 45.8% nuk e konsiderojnë formë të dhunës “kontrollin mbi personin se ku mund të shkojë e ku jo”.
- ▶ 33.9% mendojnë se është “e natyrshme që dhuna në familje ndodh kur dikush pi alkool”.

*P.S. Në rast se akoma po mendoheni, **ASNJËRA nga këto deklarata nuk qëndron! Asnjëherë nuk ka arsytim për dhunën në familje!! ASNJËHERË***

Ne ishim duke ndërhyrë,
por kam dëgjuar se gruaja e
tradhtonte burrin e saj
[Zyrtari policor]

Nuk ka arsytim për mos-hetime